



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01. nr. 031 - 112404, më 12.5.2014

Në pajtim me dispozitat e neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të neneve 52 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, pas propozimit të dhënë nga Këshilli i drejtorëve, më 12.5.2014, nxjerr këtë

V E N D I M

PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë vendim caktohet kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të bugetit të Komunës së Prishtinës nga fondi për subvencione dhe transfere për mbështetje të personave fizikë dhe juridikë.

Neni 2.

Bazuar në fondin për subvencione dhe transfere për vitin në vijim, të përcaktuar në buxhetin vjetor të Komunës së Prishtinës, i miratuar në Kuvendin Komunal, Kryetari i Komunës ndan mjete financiare si përkrahje për personat juridikë dhe fizikë.

Neni 3.

Përkrahja e dhënë nga fondi për subvencione dhe transfere përfshin pagesës së njëanshme, jo të kthyeshme, për personat juridikë dhe fizikë.

Neni 4.

Komuna ndan subvencione për këto fusha: kulturë, rini, sport, shëndetësi, mirqenie sociale, zhvillim ekonomik, rural dhe të arsimit.

Neni 5.

Shuma e lejuar e subvencioneve do të caktohet në Vendimin për ndarjen e subvencioneve.

Neni 6.

Me vendim të kryetarit të Komunës, në fillim të vitit, buxheti i përgjithshëm për subvencione dhe transefere, ndahet për fushat e cekura më lartë.

Neni 7.

Drejtoritë përkatëse për fushta, për të cilat ndahen subvencionet, në fillim të çdo viti, në planin e tyre të punës parashohin objektivat, projektet dhe aktivitetet, që do të mbështeten me subvencione gjatë vitit përkatës. Këto objektiva, projekte dhe aktivitete miratohen paraprakisht nga Kryetari i Komunës.

II. SHQYRTIMI I KËRKESAVE

Neni 8.

Drejtoritë përkatëse, që mbulojnë fushat për të cilat ndahen subvencionet, obligohen që të pranojnë kërkesat për subvencione nga palët e interesuara (persona fizik dhe juridik). Këto kërkesa duhet të pranohen në bazë të një formulari për kërkesa, i cili ndër të tjera përmban: qëllimin e kërkesës, aktivitetet kryesore të projektit bashkë me koston e tyre, efektet që do të arrihen etj. Formularit duhet ti bashkëngjiten edhe dokumente identifikuese të organizatës ose personit që bënë kërkesën.

Neni 9.

Bazuar në nevojat të arsyetuara të drejtorive, komuna mund të shpallë "thirrje për propozime" nga palët e interesuara për realizimin e projekteve të caktuara, që mbulohen përmes subvencioneve. Kushtet specifike për "thirrje për propozime" përcaktohen paraprakisht nga drejtorita përkatëse.

Neni 10.

Kryetari i Komunës i cakton komisionet për ndarjen e subvencioneve sipas fushave. Komisionet janë në përberje të pesë (5) anëtarëve. Anëtar të komisionit janë nga Drejtoria, ekspert të jashtëm dhe nga shoqëria civile.

Neni 11.

Komisionet për ndarjen e subvencioneve mbledhen së paku një herë në tre muaj dhe shqyrtojnë kërkesat, nga palët që kanë arritur gjatë tremujorit përkatës. Në këtë mbledhje, komisionet i propozojnë Kryetarit kërkesat/projektet për mbështetje deri në shumën e subvencioneve, që është caktuar për tremujorin përkatës.

Neni 12.

1. Propozimet e komisioneve për mbështetje të kërkesave/projekteve bëhen në bazë të:

- a) Përputhshmërisë së qëllimeve të kërkesës/projektit me objektivat për ndarjen e subvencioneve të përcaktuar nga ana e drejtorisë përkatëse dhe
- b) Kritereve për ndarjen e subvencioneve, të përcaktuara në këtë vendim.

2. Kërkesat/projektet e pakompletuara komisionet nuk i procedojnë më tutje.

Neni 13.

Lista e kërkesave/projekteve të propozuara nga komisionet për ndarjen e subvencioneve, së bashku me arsyetimin e shkurtër për secilin kërkes/projekt, i dërgohet Kryetarit të Komunës për shqyrtim të mëtejshëm dhe miratim. Kryetari miraton kërkesat e justifikuara dhe të dëshmuara me dokumentacionin përcjellës.

Neni 14.

Kryetari i Komunës merr vendim për mbështetje deri në shumën e përcaktuar në buxhetin për subvencione. Nëse përkrahja katë bëjë me shumë më të madhe se sa mjetet, që mund të ndahen përmes subvencioneve, atëherë kërkesa procedohet në Komitetin për Politik dhe Financa, respektivisht Kuvendin e Komunës për miratim.

III. KRITERET PËR PËRKRAHJEN NGA SUBVENCIONET

Neni 15.

Kriteret për ndarjen e subvencioneve janë pjesë e Rregullores dhe ato mund të ndryshojnë nga viti në vit, varësisht nga objektivat, që ka drejtoria përkatëse.

1. Subvencioni në fushën e kulturës

Neni 16.

1. Në fushën e kulturës mbështeten, në mes tjerash, këto projekte:

- a) Festivalet, koncertet, shenimet e datave historike dhe kulturore, simpoziumet, ekspozitat dhe promovimet e librave të botuara;
- b) Veprimtaria botuese;
- c) Veprimtaria teatrale,
- d) Veprimtaria kinematografike;
- e) Artet pamore;
- f) Veprimtaria e grupeve/shoqërive kulturore dhe artistike të Kryeqytetit.

2. Kriteret që duhet të përfillen për mbështetje të kërkesave/projekteve nga paragrafi 1, përfshijnë:

- a) Projekti duhet të ketë vlera krijuese – artistike, të trashigimisë kulturore, etj;
- b) Tek botimet mbështetën kryesisht shpenzimet e shtypit;
- c) Vlerësimi i veprimtarisë teatrale bëhet në bazë të shpenzimeve të shfaqjeve teatrale;
- d) Veprimtaria kinematografike vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve të kalkuluara sipas zhanrit dhe skenarit;
- e) Në artet pamore me tepër subvencionohet botimi i katalogëve dhe përgatitja e kornizave për piktura;
- f) Grupet shoqëritë kulturore dhe artistike që funksionojnë në kryeqytet mbështeten bazuar në realizimin e sukseshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake.

3. Kriteret, që duhet të përfillen për mbështetje të kërkesave/projekteve nga pika më sipër përfshijnë:

- a) Projekti duhet të ketë vlera krijuese-artistike, të trashigimisë kulturore etj.
- b) Tek botimet mbështeten kryesisht shpenzimet e shtypit,
- c) Vlerësimi i veprimtarisë teatrale bëhet në bazë të shpenzimeve të shfaqjes teatrale,
- d) Veprimtaria kinematografike vlerësohet sipas pozicioneve buxhetore të shpenzimeve, të kalkuluara sipas zhanrit dhe skenarit,
- e) Në artet pamore më tepër subvencionohet botimi i katalogëve dhe përgatitja e kornizave për piktura,
- f) Tek hulumtimi i trashëgimisë mbështeten kërkesat sipas rëndësisë së objekteve që duhet hulumtuar dhe ruajtur.
- g) Grupet/shoqëritë kulturore dhe artistike që funksionojnë në kryeqytet mbështeten bazuar në realizimin e sukseshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake,



h) Projektet që mund të mbështeten janë: pjesëmarrja në festivale në vend dhe jashtë, koncertet, gardëroba për atë veprimtaria artistike, instrumentet muzikore, ndihmë logjistike (sigurimi i sallave për mbajtjen e koncerteve, transportit etj.), shfaqjet teatrale, koncertet, orët letrare garat e ndryshme, rekuzitat, nxjerrja e publikimeve (revista, harta. Broshura, ftesa, pllakate, mirënjohje etj.), shpenzimet e zërimit dhe ndriçimit të sallave dhe koncerteve etj.

3. Në rast se vlersohet e nevojshme, subvencionet për kulturë mund të përdoren edhe për të mbështetur ndonjë aktivitet të institucioneve të kulturës, të cilat janë në varësi të Komunës, Në raste të tilla, vlejné kriteret e specifikuara më lartë.

2. Subvencionimi në fushën e rinisë dhe sportit

Neni 17.

1. Nga lëmi i rinisë dhe sportit, mbështeten këto projekte/aktivitete:

- a) Masivizimi i sportit për të rinj,
- b) Përgaditja e sportistëve,
- c) Përkrahja për sportistët kulmorë dhe klubet e suksesshme,
- d) Avancimi i aktiviteteve në klubet sportive të femrave,
- e) Bashkëpunimi me organizata të ndryshme sportive, vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme sportive, që kanë me avancimin e trajnerëve, të cilët punojnë me grup-mosha të ndryshme,
- f) Integrimi i minoriteteve në aktivitete dhe gara,
- g) Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive,
- h) Përkrahja e Shoqatës së Pedagogëve të Kulturës Fizike, me qëllim të zhvillimit të ligës shkollore në nivel lokal dhe rajonal,
- i) Aktivitete edukative me simpatizantë me qëllim të evitimit të dhunës dhe kultivimit të vlerave fisnike të sportit,
- j) Mbështetjen për Qendrën Kulturore të të Rinjve në Prishtinë etj.

2. Kriteret që duhet të përfillen për mbështetje të kërkesave/projekteve nga pika e mësipërme përfshijnë:

- a) Promovimin e vullnetarizmit,

Fora I

- b) Integrimin e grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara,
- c) Projekte që ndikojnë në fuqizimin e organizatave rinore (stimulimi i të miturve për edukim dhe arsimim),
- d) Punësimin e të rinjve etj.

3. Subvencionimi në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

Neni 18.

1. Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale mbështeten projektet/aktivitetet në vijim:

- a) Trajnimet profesionale brenda dhe jashtë Kosove (që kanë për qëllim ngritjen profesionale të profesionistve shëndetësor dhe socialë);
- b) Veprimtaria botuese shëndetësore: Librat, fletushkat, katalogjet;
- c) Aktivitetet edukativo – informuese, që kanë për qëllim , promovimin e ruajtjes së shëndetit publik të qytetarëve;
- d) Aktivitet edukative shëndetësore me grupet vulnerable, veqanërisht me grupet moshat parashkollore, shkollore dhe ato të rinjve;
- e) Hulumtimet dhe studimet e dukurive dhe fenomeneve si më poshtë, (por jo të kufizohen vetëm në kohë): shkalla e referimit nga KPSH, përshkrimi i antibiotikve nga ana e Mjekësisë familjare, shfrytëzimi i barnave nga Lista esenciale e barnave;
- f) Ngritja profesionale.

2. Kriteret që duhet të përfillen për mbështetjen e projekteve të mësoërme:

- a) Target grupet esynuara, qëllimi dhe objektivat e projekteve të përputhen me synimin dhe objektivat e DSHMS;
- b) Për pjesëmarrje në konferenca, seminare, kongrese dhe trajnime jashtë vendit të dokumentohet ftesa e organizatorit; përparsi dotë kanë profesionistët shëndetësorë dhe socialë që prezantojnë punimet shkencore, dhe ngritja profesionale e të cilëve do të kontribuojë në rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale;
- c) Tek veprimtaria botuese, mbështeten kryesisht shpenzimet e botimit;
- d) Tek aktivitetet edukative, për bazë do të mirret numri i përfituesve të drejtëpërdrejtë si dhe qëndrueshmëria e projektit edhe pas përfundimit të projektit;

4. Subvencionimi në fushën e ndihmës sociale.

Neni 19.

1. Kryetari i Komunës lejon ndarjen e subvencioneve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Subvencionet nga ky nen përfshijnë:

- a) Rastet me varfëri të skajshme;
- b) Rastet me sëmundje të rënda që kërkojnë mjekim të kushtueshëm;
- c) Organizata me veprimtari bamirëse për persona me nevoja të veçanta dhe
- d) Raste të jashtëzakonshme nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore.

3. Kriteret që duhet të plotësohen për të qenë përfitues i ndihmes në raste të tilla janë:

- a) Sëmundja e rëndë me trajtim të kushtueshëm e konstatuar me dokumentacionin përkatës mjekësor, me ç'rast komisioni përkatës e vërteton gjendjen e rëndë materiale të aplikuesit.
- b) Gjendja e rëndë ekonomike, e shënuar përmes dokumentacionit përkatës,
- c) Dëshmia e shpenzimeve mjekësore dhe shpenzimeve tjera dhe
- d) Dëshmia për dëmet e shkatuara nga fatkeqësia elementare.
- e) Projekte nga organizata joqeveritare ku kanë si qëllim ndihmën dhe përkrahjen për persona me nevoja të veçanta".

4. Kërkesën për ndihmë (subvencionim) mund të paraqesin vetëm personat dhe familjet, duke përfshirë edhe subjektet juridike jofitimprurëse që janë banorë të përhershëm apo kanë selinë e tyre në Komunën e Prishtinës. Palët mund të ndihmohen vetëm një herë në vit, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

5. Subvencionimi në fushën e arsimit

Neni 20.

1. Nga fusha e arsimit, subvencionet ndahet për të promovuar zhvillimin e garave në institucionet arsimore të Komunës së Prishtinës në vendë dhe jashtë vendit, për aktivitete të nxënësve dhe arsimtarëve, për trajnime dhe publikime me qëllim të avancimit të procesit edukativo-mësimor, aktivitete promovuese të institucioneve shkollore, pjesëmarrje në aktivitete kombëtare, mbështetje të talentëve të veçantë dhe arritje të larta, ndarjen e bursave.

2. Subvencionet për këto raste ndahen sipas kërkesave të arsyetuara të paraqitura nga institucionet arsimore, arsimtarët, nxënësit, studentët.

6. Subvencionet në fushën e zhvillit ekonomik dhe rural

Neni 21.

1. Subvencionet për fushën e zhvillit ekonomik dhe rural ndahen për të promovuar zhvillimin e biznesit (kryesisht bizneseve të vogla dhe të mesme), zhvillimin e fermave, serave, blektorisë, perimtarisë dhe pemëtarisë, bletarisë, dhe aktitete të tjera mbjelljet pranverore dhe vjeshtore, trajnimet për bujqësi, ofrimin e shërbimeve të veterinarisë për fermerë etj.

2. Subvencionet për këto raste ndahen në bazë të planit vjetor të paraqitur nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit kërkesave të arsyetuara të personave fizik dhe juridik dhe kritereve të zhvilluara nga kjo drejtori për secilën fushë mbështetet me subvencione të paraqitur në pikën paraprake të këtij neni.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22.

Për zbatimin e këtij udhëzimi, kompetent janë drejtoritë përkatës për të cilat ndahen subvencionet dhe drejtoria përgjegjëse për financa.

Neni 23.

Komisioni për ndarjen e subvencioneve vepron në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjshmëris dhe konform autorizimeve, që i jepen nga Kryetari i Komunës.

Neni 24.

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të këtij vendimi bëhen sipas procedurës së miratimit.

Neni 25.

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlejë vendimi për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve.

Neni 26.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

IU DORËZOHET:

- Drejtorëve të drejtorive;
- Qendrës për shërbime me qytetarë.

